



Cilat institucione monitorohen?

Projekti fokusohet në monitorimin e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administrimit, Agjencisë së Administratës, komisionet përkatëse, por, mbi të gjitha, institucionet në shërbim të qytetarëve nga fusha të ndryshme si: shëndetësi, punë sociale, policia, vetëqeverisja lokale, shërbimet komunale etj.

Projekti përfshin më shumë se 160 institucione kombëtare dhe lokale, dhe më shumë se 3.200 qytetarë të përfshirë në hulumtim, ose në kuadër të diskutimeve dhe takimeve të ndryshme.



**QENDRA PËR
MENAXHIM ME
NDRYSHIME**

Projektin e realizon organizata:

Qendra për menaxhim me ndryshime (QMN)

Rr. "Rajko Zhinzifov" 44/1, 1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë

Faqja e internetit: www.cup.org.mk

E-mail adresa: info@cup.org.mk

Tel. fax: 02 6092-216



**British Embassy
Skopje**

Projekti është i mbështetur nga Ambasada Britanike në Shkup.

Ambasada Britanike Shkup mbështeti përgatitjen e këtij afishi, brenda projektit "Monitorim i Drejtësisë Administrative". Përmbajtja e këtij afishi nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës Britanike.

MONITORIM I DREJTËSISË ADMINISTRATIVE



**MONITORIM I
DREJTËSISË
ADMINISTRATIVE**

Kohëzgjatja e projektit:

gusht 2016 - mars 2018

Çfarë monitorohet me projektin?

Projekti monitoron zbatimin e dispozitave ligjore për të krijuar një administratë shtetërore dhe publike efikase dhe profesionale. Monitorohen shumë gjendje që janë të rëndësishme për funksionimin e administratës shtetërore dhe publike. Globalisht, vëzhgohet vëllimi dhe efikasiteti i administratës shtetërore në raport me qëllimin final, të plotësojë nevojat e qytetarëve me shërbime adekuate.


Monitorimi në mënyrë specifike përfshin:

- procedurat dhe procesi i punësimit.
- ndikimi i mundshëm politik ose çdo lloj ndikimi tjetër në punësim,
- përfaqësimi i drejtë i bashkësisë etnike
- shpërndarja dhe delegimi i përgjegjësisë,
- kryerja e detyrave dhe cilësia e shërbimeve për qytetarët,
- vlerësimi i punonjësve dhe avancimi sipas meritave,
- krijimi i mundësive për avancim në karrierë, si dhe përpilimi i planit për zhvillim personal dhe profesional etj.

O

bjekt i monitorimit është edhe mënyra e ngritjes dhe zgjidhjes së të gjitha mosmarrëveshjeve që mund të lindin në administratën shtetërore dhe publike, në marrëdhëniet ndër-njerëzore mes kolegëve, me eprorët në vendin e punës etj. Projekti praktikisht do të monitorojë ankesat dhe pakënaqësitë e ngritura nga të punësuarit në **Komisionin për vendimarrje mbi ankesat dhe pakënaqësitë e administratës të shkallës së dytë**. Ato do të përcaktohen dhe analizohen sipas llojit dhe vëllimit të ankesave dhe pakënaqësive. Do të shqyrtohet në mënyrë plotësuese si zbatohen të gjitha vendimet e marra nga vetë komisioni në vetë institucionet. Pra, do të nxirren konkluzione adekuate dhe rekomandimet për zgjidhjen më të mirë të të gjitha mosmarrëveshjeve apo trajtimeve të padrejta të punonjësve, si dhe konkluzionet në avancimin e marrëdhënieve të punës në vetë institucionet.

Po ashtu do të monitorohen kontestet administrative, si mundësi e punonjësve për të ngritur kontest gjyqësor në raste kur nuk janë të kënaqur me vendimet e mëparshme. Rezultati i tyre dhe realizimi në nivelin e institucioneve do të tregojë se çfarë duhet të ndryshohet në këtë pjesë të punës së gjyqësorit dhe veprimit në rastet. Do të monitorohen edhe temat në lidhje me programet dhe buxhetin e institucioneve, do të shqyrtohet raporti i destinuar për paga dhe shërbime të tjera, si dhe disa tregues të tjerë në lidhje me numrin e të punësuarve në administratë dhe shpenzimin që secili prej nesh e ndan për paga të të punësuarve apo lloje tjera të shpenzimeve për shërbime të caktuara.



Çfarë në fakt është më e rëndësishme?



Në fund të fundit, projekti do të shqyrtojë dhe do të konstatojë opinionin e qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore, institucioneve publike dhe/ose organeve të administratës shtetërore.

Kjo pjesë ka një karakter shumëdimensional dhe shërben për përmirësimin e drejtësisë administrative në shërbim të qytetarëve. Ata do të jenë objekt i monitorimit dhe analizës dhe do të nxirren treguesit e duhur të (pa)kënaqësisë së qytetarëve, çfarë është ajo (pa)kënaqësi në mënyrë specifike, cilat institucione janë më kritike, çfarë mendojnë qytetarët për punën e punonjësve të administratës, etj. Të dhënat do të merren me disa anketa dhe hulumtime për të përcaktuar opinionin publik mbi çështje të caktuara me interes për qytetarët. Në përputhje me këtë, do të propozohen edhe masa për përmirësimin e gjendjes në institucionet.

Pse zbatohet një projekt i këtillë?

Projekti synon të kontribuojë në përcaktimin e situatës reale në administratën tonë, identifikimin e pikave kritike dhe miratimin e rekomandimeve dhe zgjidhjeve të duhura, propozim-masa të reja, procedura të reja, protokolle adekuate për punë, vendime ose rregullore etj. Përveç kësaj, projekti do të hapë një debat të gjerë publik dhe do ta rrisë ndërgjegjësimin e procedurave administrative dhe shërbimeve në funksion të rritjes së efikasitetit të administratës publike dhe shtetërore.

Projekti do të ofrojë mënyra të reja të zbatimit efektiv të procedurave të caktuara në vetë institucionet. Kjo, në plan të brendshëm, do të thotë staf më i kënaqur, angazhim më të madh në vendin e punës dhe avancim në bazë të meritës. Gjithçka me qëllim që të arrihet një administratë më efektive dhe efikase për të mirën e qytetarëve dhe për të krijuar institucione funksionale që ofrojnë shërbime të shpejta dhe me cilësi të lartë për qytetarët.

Çfarë aktivitete zbatohen me projektin?

Aktivitetet fillojnë me përpunimin e një matrice të treguesve-punësime, konteste të krijuara, qytetarë të kënaqur etj. Bazuar në këtë, ka pasur një protokoll të përshtatshëm për mbledhjen e të dhënave, sipas të cilit më pas kërkohen të dhënat nga EUROSTAT dhe Enti shtetëror i statistikave dhe përgatiten tabela përkatëse.

Përveç kësaj përpunohen edhe:

- kërkesa specifike për qasje të lirë në informatat me karakter publik dhe ata drejtohen deri te institucionet,
- anketa dhe pyetësorët që realizohen në terren, me telefon ose brenda diskutimeve me grupet përkatëse të qytetarëve ose të punësuarve në administratën publike.

Të dhënat ruhen dhe ato pastaj përpunohen sipas llogaritjeve të caktuara dhe/ose grafiku shfaqet paraqiten në formë të tabelave, grafikëve apo ilustrime të tjera të kuptueshme për qytetarët. Ato të dhëna pastaj prezantohen para qytetarëve ose të punësuarve në administratë dhe kërkohen zgjidhje për probleme të caktuara të cilat janë gjetur.

Projekti pasohet nga takime të ndryshme brenda institucioneve me nëpunësit administrativ, përgjegjësit në institucionet përkatëse dhe qytetarët. Kjo bëhet përmes shpalljeve adekuate, takimeve publike, debateve, takimeve institucionale dhe takimeve për miratim të vendimeve të caktuara, konferencave në të cilat kërkohen dhe ofrohen zgjidhje të caktuara etj.